**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*
**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**
Divizioni i Prokurimit/ Divizia Nabavke/ Procurment Division

Prishtine datë, 24.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë se Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores per Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **21.11.2023,** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **"D & T Group" SH.P.K.,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender - Furnizim me Autoambulanca për nevoja te MSh-së** me nr. të Prok: **206-23-11548-1-1-1,** nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet,** si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K e dt. 21.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ritender - Furnizim me Autoambulanca për nevoja te MSh-së** me nr. të Prok: **206-23-11548-1-1-1** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 17.11.2023;

2. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 17.11.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K me date 21.11.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender - Furnizim me Autoambulanca për nevoja te MSh-së** me nr. prokurimi **206-23-11548-1-1-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 23.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE **"D & T Group" SH.P.K**:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

**Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Te nderuar,

Me datën 17.11.2023, Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se, ku eshtë shperblyer me kontrate Gr. I OE: “MADEKOS SH.P.K.; & ES INDUSTRY SH.P.K.” per aktivitetin e prokurimit me titull: Titulli: Ritender - Furnizim me Autoambulanca për nevoja te MSh-së, me nr prokurimi: 206-23-11548-1-1-1.

Ndërsa ne letër standarde, kundrejt ofertës se Gr. te OE: “D&T Group SH.P.K. & Mercom Company SH.P.K.” si arsyetim te eliminimit keni përcaktuar:

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye:
Oferta juaj është e pa përgjegjshme për arsye se nuk e keni plotësuar kriterin nr. 4 te Kërkesat mbi
mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2
Kërkesa 4. OE duhet te dorzoj katalogun me karakteristika teknike te prodhuesit duke përfshi
edhe shpenzimet e karburantit te Autoambulances se ofertar dhe pajisjeve mjekesore nga prodhuesi.
Dëshmia 4. Katalogu me ngjyra
autoambulancës qe ofertoni me karakteristika teknike te
automjetit dhe pajisjeve mjekësore. Ne katalog duhet qe te jene te shënuara shpenzimet e karburantit te automjetit ne 100 km.
I. Ne katalogun e ofruar te dhënat rreth vëllimit dhe fuqisë se motorit te Automjetit janë te dhëna qe nuk korrespondojnë me te dhënat qe janë ne faqet zyrtare te Prodhuesit te Automjeteve. Ka ofrua 120BHP (asnjë model i boxer nuk e ka një fuqi te tille, nëse e kthejmë ne KW po i bije 89.484, parameter ky qe nuk është normale me asnjë lloj Autoambulancave. derisa ne faqen zyrtare ka dy modele motorësh Power: 81 kw (110 hp); Power: 96 kw (130 hp)

Po ashtu tek Nen-kriteri për Shpenzimet mesatare të karburantit në 100 km, ne ciklin e përzier urban dhe ndër-urban ku ne katalogun e ofruar te prodhuesit te prezantuar nga ana juaj dhe ne formularin e tenderit, është 7 litër ne 100 km, derisa ne te dhënat nga web faqja cars-data.com del qe shpenzimet e kombinuara i ka mate larta.
2. Tek pajisjet mjekësore ka prezantuar katalogun për Pompe infuzioni me shiringe te GIMA me kod 35205 dhe pas verifikimeve ne webfaqen e prodhuesit www.gimaitaly.com këto specifika nuk përputhën me ketë pajisje Pompe infuzioni sipas code: 35205 ne webfaqe ka mospërputhshmëri te specifikave.

3. Tek pajisjet mjekësorë te prodhuesit Fazzini Italy, te gjitha specifikat janë te marruara nga dosja e tenderit dhe te vendosura ne katalog.

Pretendimi ankimor 1.

Ne Gr. i OE: "D&T Group SH.P.K. & Mercom Company SH.P.K." pretendojme se jemi eleminuar padrejtesisht pasi qe modeli I Peugeot Boxer L2H2 88kw/120hp ekziston dhe si prove gjeni te bashkelidhur katalogun nga web faqja zyrtare e Peugeot https://business.peugeot.co.uk dhe mund te verifikohet ne kete link https://business.peugeot.co.uk/content/dam/peugeot/uk/b2b/buy/price---spec/pdfs/boxer.pdf, faqe 10.

Gjithashtu ne web faqen e Euroimpex – Perfaqesues i autorizuar i brendit Peugeot I cili ne katalogun e tij te prezantuar ne web faqe https://www.euroimpex.com.mk/eng/, mund te vertetohen shpenzimet e automjeteve Peugeot Boxer me pak dhe me shume te fuqishme se modeli 88kw/120hp, ku asnjeri nga modelet e prezantuara ne katalogun zyrtar nuk I kalon shpenzimet e kombinuara 6.2liter/100km.

Prove: Katalogu I bashkelidhur dhe linku per verifikim:
https://www.peugeot.com.mk/katalog-Boxer.pdf

Ne kemi ofertuar me 7liter/100km pasi qe kemi llogaritur edhe peshen shtese te mbindertimit te autoambulances dhe pajisjeve mjekesore.

Pretendimi ankimor 2.

Ne Gr. I OE "D&T Group SH.P.K. & Mercom Company SH.P.K." kemi dhene deklaraten nen betim se do ti plotesojme te gjitha specifikimet teknike te kerkuara nga ju si AK dhe te gjitha autoambulancat se bashku me gjitha pajisjet mjekesore do te dorezohen ashtu siç jane kerkuar dhe ofertuar ne katalog.

Pretendimi ankimor 3.

Ne kosiderojme qe AK gjate ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave nuk ka ekzaminuar mire oferten e Gr. te OE te rekomanduar per kontrate pasi qe shumica e dokumenteve te ofertes se tyre jane cilesuar dhe pranuar nga AK si sekret afarist.
Ne kemi kerkuar qasje ne dokumentacion dhe me daten 20.11.2023 kemi pranuar nga AK keto dokumente si me poshte te cilat jane pjese e ofertes se Gr. e OE te rekomanduar per kontrate,

- 1Certifikata e Regjistrimit te Biznesit ES INDUSTRY SHPK
- 2Certifikata e Tvsh-se_ ES INDUSTRY
- 10. Deklarata OE
- 16. Aneksi 3 K RKES P R KONFIDENCIALITET (jo e GR. Te OE te rekomanduar per kontrate por e D&T Group dhe Mercom Company)
- 21869923-43a4-4414-97a1-05477ddd472d (lidhja e ofertes)
- Certifikat e Re Madekos shpk
- Certifikata e TVSH Madekos shpk
- Made-Kos Doc NUI e vjeter
- Madekos liqenca 2019-2024 VALIDE
- Pjesa II. Përshkrimi i Çmimeve (2)
- Raporti i Vleresimit te Tendereve MSH Ritender Furnizim me Autoambulanca (kopje fizike)

Duke u bazuar ne kerkesen per konfidencialitet te Gr. e OE te rekomanduar per kontrate e cila gjindet te dokumenti i emertuar 10. Deklarata OE, faqe 4, shihet qarte se emertimi i dokumenteve te listuara si sekret afarist : 1. Autorizime; 2. ISO; 3. CE, Katalog dhe Lista e kontratave me Referenca, nuk perkojne me emertimet e listuara ne lidhjen e ofertes, siç jane emertuar me saktesi nga Gr. i OE "D&T Group SH.P.K. & Mercom Company SH.P.K.", por vetem jane cekur ne pergjithesi.
Duke mos pasur qasje ne te gjitha dokumentet e Gr. e OE te rekomanduar per kontrate per te vertetuar se oferta e tyre eshte e pergjegjshme dhe I ploteson te gjitha kushtet dhe kriteret e dosjes se tenderit duke perfshire saktesisht:
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1 & 9.2: Kapaciteti teknik dhe professional Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses kontrata te ngjashme në 3 (tri ) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 1.3 milion euro.
1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për liferimin e furnizimeve. Listës duhet ti bashkëngjiten a) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohet referenca të lëshuara nga autoriteti i tillë; Ne reference duhet qe te jete shënuar vlera e realizimit te furnizimeve. b) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë. Çdo dokument duhet qe ta ketë shënuar vlerën e realizimit te furnizimeve.
2. Ne rast se nuk jeni prodhues, OE duhet te dorëzoj autorizimin e notarizuar, nga prodhuesi (ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi) se jeni i autorizuar për shitjen dhe servisimin e autoambulancave qe ofertoni. Në autorizim përveç tjerash duhet te shënohet edhe emri i Autoritetit Kontraktues, numri dhe titullin e aktivitetit te prokurimit.
2. Autorizim nga prodhuesi (ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi ) se jeni i autorizuar për shitjen dhe servisimin e Autoambulantave qe ofertoni. - Kopje e Noterizuar (me te dhenat e kontaktit te leshuesit te autorizimit).
3. OE duhet te dorëzoj specifikimin teknik te detajuar për autoambulantet e ofruara.
3. Kopje e Specifikimit teknik te detajuar.
4. OE duhet te dorëzoj katalogun me karakteristika teknike te prodhuesit duke përfshi edhe shpenzimet e karburantit te Autoambulances se ofertuar dhe pajisjeve mjekesore nga prodhuesi.
4. Katalogu me ngjyra i autoambulancës qe ofertoni me karakteristika teknike te automjetit dhe pajisjeve mjekësore. Ne katalog duhet qe te jene te shënuara shpenzimet e karburantit te automjetit ne 100 km.
5. OE duhet te dorëzoj Certifikatën ISO për Prodhuesin e automjetit dhe pajisjeve mjekësore.
5. Kopje e Certifikatës ISO, me validitet.
6. OE duhet te dorëzoj Deklaratën e Konformitetit ose CE, per automjetin dhe pajisjet mjekësore.
6. Kopje e Deklarates se Konformitetit ose kopje e CE, me validitet.
7. OE duhet te ofroje minimum 3 vite garanci për pajisjet e ofruara (të gjitha pjesët e këmbimit, duke përfshirë përditësimet).
7. Kopje e Deklarates nga prodhuesi ose distributori.
8. OE duhet te dëshmoj mbështetjen me pjesë rezervë nga prodhuesi ose nga distributori, për së paku 10 vite për autoambulancë dhe 7 vite për pajisje mjekësore.

8. Kopje e Vërtetimit nga prodhuesi ose nga distributori.
9. Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME- Lista e pjesëve rezervë dhe/ose artikujve të konsumit duhet të përpilohet nga tenderuesi, nga përvoja e tijë profesionale dhe duke marrë parasysh vendet e përdorimit.

Ne e kemi te pamundur te vertetojme dyshimet tona qe ne i konsiderojme te arsyeshme se Gr. I OE i rekomanduar per kontrate ka realizuar me sukses kontrata te ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit ne vleren e percaktuar nga AK, duke marre parasysh se furnizimi i kërkuar nga AK kerkon mjete motorike (autoambulanca) dhe kontrata te ngjajshme konsiderohen vetem ato te cilat perfshijne mjetet motorike.

Ne e kemi te pamundur te vertetojme se Gr. I OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar ne oferte te gjitha autorizimet duke perfshire ketu autorizimin e prodhuesit te automjetit te noterizuar, autorizmin e prodhuesve te pajisjeve mjekesore.

Ne e kemi te pamundur te vertetojme se Gr. I OE i rekomanduar per kontrate ka prezantuar ne oferte deklaratat e konfirmitetit CE per automjetin dhe per te gjitha pajisjet mjekesore, dhe certifikatat ISO.

Ne e kemi te pamundur te vertetojme se Gr. I OE i rekomanduar per kontrate ka prezantuar ne oferte garancionin 3 vite per te gjitha pajisjet mjekesore dhe mbeshtetjen me pjese rezerve per 7 vite per pajisje mjekesore dhe 10 vite per autoambulance (keto te fundit te kerkuara nga prodhuesi ose distributori) Ne e kemi te pamundur te vertetojme se Gr. I OE i rekomanduar per kontrate ka prezantuar ne oferte katalogun/broshuren e automjetit te ofertuar ka perdorur gjuhet e lejuara ne dokumentet e prokurimit publik sipas LPP-SE Ligji Nr. 04/L-042 Neni 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik – paragrafi 4.

Pretendimi ankimor 4.

Ne lidhjen e ofertes se Gr. I OE te rekomanduar per kontrate mund te vertetohet se automjeti i ofertuar qe ne supozojme se eshte i brendit OPEL duke u bazuar ne emertimin e dokumentit 9. ISO dhe Deklarata e konformitetit Opel.rar i cili gjindet ne lidhjen e ofertes, Shpenzime mesatare të karburantit në 100 km ne ciklin e përzier urban dhe ndërurban i ka 8 Liter / 100km.

Kerkojme nga AK qe ne rastin e vleresimit te kerkeses tone per rishqyrtim te beje verifikimin e gjithe dokumentacionit te Gr. te OE te rekomanduar per kontrate apo te konfirmoje se a eshte verifikuar saktesia edhe autorizimet e prodhuesit duke perfshire ate te automjetit dhe pajisjeve mjekesore, katalogun e automjetit dhe pajisjeve mjekesore, CE certifikatat, ISO certifikatat dhe kerkesat tjera te permendura me larte.

Bazuar ne faktet, provat dhe dheshmit e prezantuara me larte dhe atyre te bashkangjitura ne oferte, kërkojmë qe AK – Ministria e Shëndetësisë te nxjerre kete vendim:
Te aprovohet, kërkesa për ri shqyrtim si e bazuar,
Te anulon, propozimi për dhënie te kontratës dhe ,
Te kthehet lënda ne Ri shqyrtim dhe te behet vlerësim real i ofertave .

**Dëmet materiale**

**- Demet janë te shumëfishta, ne aspekt moral dhe material dhe rrezikimi i demtimit te buxhetit publik te Republikes se Kosoves.**

**Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore**

E kemi shqyrtuar kerkesen tuaj per rishqyrtim dhe konstatojme se pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara, meqense oferta juaj eshte e pa pergjegjshme, per arsyet e cekura ne B58-Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 17.11.2023 dhe B42-Letren standarde për tenderuesin e eliminuar.

- Nuk pajtohemi me pretendimin tuaj nr. 1, sa i përket katalogut te ofruar nga ana juaj, pasi qe te dhënat rreth vëllimit dhe fuqisë se motorit te Automjetit janë te dhëna qe nuk korrespondojnë me te dhënat qe janë ne faqet zyrtare te Prodhuesit te Automjeteve. Keni ofruar 120 BHP, asnjë model i boxer nuk e ka një fuqi te tille, nëse e kthejmë ne KW po i bijë 89.484, parametër ky qe nuk është normale me asnjë lloj Autoambulancave, derisa ne faqen zyrtare ekzistojnë dy modele motorësh Power: 81 kw (110 hp); Power: 96 kw (130 hp):

<table>
<tr><th>OFERTA E OE</th><th>TE DHENAT ZYRTARE</th></tr>
<tr><td>
<table>
<tr><td>peration, performance and physical characteristics of the vehicle</td><td></td></tr>
<tr><td>e provide maximum safety, equipments and supplies</td><td></td></tr>
<tr><td>ounted on the vehicle are laterally balanced</td><td></td></tr>
<tr><td>ont/rear load that is proportional to the axle load</td><td></td></tr>
<tr><td>ransmission</td><td>6 Speed Manual</td></tr>
<tr><td>ower side mirrors</td><td>Yes</td></tr>
<tr><td>ront brakes</td><td>Disc</td></tr>
<tr><td>ear brakes</td><td>Disc</td></tr>
<tr><td>ront Suspension</td><td>Coil spring</td></tr>
<tr><td>ear suspension</td><td>Leaf spring</td></tr>
<tr><td>ank capacity</td><td>90 Liters + under tank 70</td></tr>
<tr><td>ir bags</td><td>Driver + Passager</td></tr>
<tr><td>ength</td><td>5415mm - Excluding rear steps, bumper guard.</td></tr>
<tr><td>idth</td><td>2000mm - Excluding mirrors, lights and safety accessories.</td></tr>
<tr><td>eight</td><td>2522mm - Including mounting equipment, excluding radio antenna.</td></tr>
<tr><td>ngine mount</td><td>Front Longitudinal</td></tr>
<tr><td>ngine displacement</td><td>2179 cm³</td></tr>
<tr><td>ngine power</td><td>120 BHP</td></tr>
<tr><td>uel type</td><td>Diesel</td></tr>
<tr><td>uel consumption - Combined</td><td>7L/100 Km</td></tr>
<tr><td>ater cooled</td><td>Yes</td></tr>
</table>
kjo tabel eshte e dyshimt pasi qe nuk perputhet me te dhanat ne faqen zyrtare te automjetit</td>
<td>EXTERIOR SIZES<br>Length:5413 mm<br>Width:2050 mm<br>Height:2522 mm<br>Wheelbase:3450 mm<br>Front Track Width:1810 mm<br>Engine Capacity:2198 cc<br>Power:81 kw (110 hp); Power:96 kw (130 hp)<br>Combined Consumption:7,4 l/100km</td></tr>
<tr><td>Nuk ka informata ne ktalog</td><td>Power:81 kw (110 hp); Power:96 kw (130 hp)</td></tr>
<tr><td></td><td></td></tr>
<tr><td>nafte</td><td>nafte</td></tr>
<tr><td>120 BHP (asnji model I boxer nuk e ka nji fuqi te till, nese e kthejm ne kW po I bje 89.484, parameter ky qe nuk eshte noe asnji lloj makine)</td><td>Power:81 kw (110 hp); Power:96 kw (130 hp)</td></tr>
</table>

Po ashtu tek Nen-kriteri sipas Dosjes se Tenderit është shpenzueshmëria e karburantit, ku ne katalogun e ofruar nga ana juaj dhe ne formularin e tenderit, shpenzueshmërine e keni deklaruar 7 litër ne 100 km, derisa ne te dhënat nga web faqja cars-data.com vërtetohet qe ky automjet shpenzimet e kombinuara i ka ma te larta.

Bazuar ne këto dëshmi, gjate vlerësimit te tenderit, me date 15/11/2023 është kërkuar nga Distributori i Autorizuar i Prodhuesit te këtij Automjeti "Euroimpex" nga Maqedonia e Veriut, përmes emailit zyrtar për te verifikuar këto te dhëna – specifikat e katalogut tuaj.

Nga "Euroimpex" kemi mare përgjigjet si me poshtë:

- **Can you please confirm that this catalogue is an authentic material from your company? – We do not stand behind this catalogue. It is not offered by our side and it is not Peugeot Official Catalogue.**

- **Can you also confirm us that the "fuel consumption-combined 7.0 L/100 km, parameter is valid for the Peugeot Boxer? – Fuel consumption offered in the catalogue are not correct. The parameter of 7L /100 km is not valid. The exact combined fuel consumption for the offered model with engine 2179 ccm / 120hp is 8.4-9.0**

Sipas konfirmimit nga Euroimpex, ata nuk qendrojne pas katalogut tuaj, nuk eshte ofruar nga ana e tyre dhe nuk eshte katalog zyrtar i Peugeot.

Gjithashtu edhe shpenzueshmëria e karburantit qe ju e keni ofruar ne Formularin e tenderit nuk është korrekte. Parametri prej 7L/100km nuk është i rregullt dhe konsumi i saktë i kombinuar i karburantit për modelin e ofruar me motor 2179 ccm / 120 hp është 8.4-9.0.

Tek pajisjet mjekësore keni prezantuar katalogun për Pompe infuzioni me shiringe te GIMA me kod 35205 dhe pas verifikimeve ne web faqen e prodhuesit www.gimaitaly.com këto specifika nuk përputhën me ketë pajisje:

| OFERTA E OE | TE DHENAT ZYRTARE NGA GIMA |
|---|---|



GIMA

2 x AUTO SYRINGE PUMP

• 35205 2 x SYRINGE PUMP SP-8800
Easy syringe installing through one-touch method by slider hook. Anti bolus system reducing pressure on sudden release of occlusion. Colour LCD displays infusion information shortcut key manages easy approach for frequent functions. K.V.O. rate, purge rate, bolus and anti bolus can be setup as operating application. Supplied with battery.
Flexible flow volume setting.
Full program dosage feature: it automatically calculates flow rate by patient's weight, flow rate settings option, injection's mass and melting.
Keep Vein Open (K.V.O.) feature: When reached to the preset value, it converts to low flow speed of 0.1 ml/h automatically to prevent flow route clog due to blood coagulation.
Standard compatibility with 5 major brands of syringes: Setting feature enables you to choose from following syringe brands: BD (Plastipak, Precise), TERUMO, RAYS, PENTAFERTE, KOVA. Each pump can be calibrated for up to 10 different syringes. Alarm and notification feature: it notifies errors and emergencies with LED light and buzzer. Simultaneous visual and audio alarm. Occlusion error range setting: you can set the pressure level of occlusion stage to High, Medium and Low by patient's age condition. Auto detect syringe size and fixation. Bar name displayed with a provision for memorizing 10 names. Wall mounting suitable also for Ambulance use.
• 35210 Ni-MH BATTERY - spare
• 35204 ADAPTER 110 V - 60 Hz - for 35205
• 35211 DOSAGE AND PROFILE PROGRAM need Serial Number

TECHNICAL SPECIFICATIONS

Flow volume setting range
Syringe 10ml: 0.1-300 ml/h
Syringe 20ml: 0.1-400 ml/h
Syringe 30ml: 0.1-500 ml/h
Syringe 50ml: 0.1-1,200 ml/h
Flow volume error margin ±2%
Infusion limit volume range
0.1-999.9ml (0.1 ml infusion interval)
Total estimated volume range
0.1-999.9ml (0.1ml infusion interval)
K.V.O (Keep Vein Open function)
0.1-10 ml/h adjustable
Size 220x130x108 mm
Weight 2 kg (battery included)

Rapid flow volume (Purge)
0.1-1200 ml/h adjustable
Bolus: adjustable 0.1-1200 ml/h
0.1-1000 ml
Alarm features
Occlusion, K.V.O. (infusion completion), standby, near empty, low battery, device malfunction (CPU error), clamp/handle lever/slider disengaged, syringe disengaged.
Special features
Keypad lock, shortcut key, return memory, remaining time, alarm repeat, open system, K.V.O., purge, bolus, anti bolus, occ. level, history call-back.

Power
AC 230V, 50/60Hz and DC9.6V inner source adapter DC 12 / 24V - 2A
Switchable at 110V / 60Hz - with adapter 35204
Maximum power consumption 45VA
Electric protection levels
Class II B, inner source device, CF type
Waterproof level IPX3
Battery type Ni-MH rechargeable
Battery using time 4 hours
Battery recharging time minimum 30 min. Battery life about 6 months.



AUTO SYRINGE PUMP

Technical Specifications

Është verifikuar specifikimi teknik i pajisjes se me sipërme 2 x Auto Syringe Pump, dhe ne baze te katalogun te ofruar nga ana juaj dhe katalogut (catalogue page 366 code 35205) ne web faqe te prodhuesit, shihet qarte se ju keni intervenuar ne katalog, duke shtuar tekstin (2 x Auto Syringe Pump).

Tek pajisjet mjekësorë ka prezantuar një katalog te Fazzini Italy, dhe te gjitha specifikat janë te marruara nga dosja e tenderit dhe te vendosura ne katalog.

- Nuk pajtohemi me pretendimin tuaj nr. 2, sa i përket faktit qe ju si grup i OE keni dhënë deklaratë nen betim se do ti plotësoni te gjitha specifikimet teknike te kërkuara nga AK dhe te gjitha autoambulancat se bashku me gjitha pajisjet mjekësore do te dorëzohen ashtu siç janë kërkuar dhe ofertuar ne katalog. Fakti qe katalogu u është kontestuar nga dileri "Euroimpex" atëherë kjo bie ndesh me deklaratat e juaja nen betim qe i keni dhënë ne këtë tender.

- Nuk pajtohemi me pretendimin tuaj nr. 3 rreth dyshimeve qe OE i rekomanduar nuk ka realizuar me sukses kontrata te ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit ne vlerën e përcaktuar nga AK, duke marre parasysh se furnizimi i kërkuar nga AK kërkon mjete motorike (autoambulanca) dhe kontrata te ngjashme konsiderohen vetëm ato te cilat përfshijnë mjetet motorike.

Kerkesa e tenderit ka qene: ***1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses kontrata te ngjashme në 3 (tri ) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 1.3 milion euro.***

Konsorciumi i rekomanduar eshte ne mes dy operatoreve ekonomik qe furnizojne automjete dhe pajisje mjeksore, pasi qe eshte autoambulancat permbajne keto dy komponente: automjetin dhe pajisjet mjeksore.

Grupi i OE te rekomanduar kane ofruar Listen dhe referencat per vleren ne total mbi 2 milion euro, qe e tejkalojne vleren e kerkuar prej 1.3 milion euro.

Sa i përket çështjes se konfidencialitetit, referojuni nenit 7 te Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

**Neni 7**
**Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion**

7.1 Tenderët në proces të tenderimit dorëzohen në baza konfidenciale. Në mënyrë që të ruhet integriteti i procesit dhe të respektohet pozita komerciale dhe konkurruese e tenderuesve, detajet e tenderëve, përveç informatave të cilat komunikohen gjatë seancës publike të hapjes, duhet të mbesin sekrete, deri në publikimin e rezultatit mbi vendimin e AK.

7.2 Qasja në të dhënat e aktivitetit të prokurimit fillon në datën e pranimit nga OE të njoftimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit – publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK.

7.3 Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuara nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente.

7.4 Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete afariste, AK do ti ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për më pak se 20 faqe A4 dhe qasje direkte të formës elektronike do të jenë të liruara nga tarifa.

7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe
b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-se.

7.6 Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse:

a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit *"Kërkesa për sekret afarist".*
b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi *Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist"*, të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të idetifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.

7.7 Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik.

Sa i përket kërkesës tuaj për qasje ne dokumentacionin e OE te rekomanduar, ne u kemi ofruar qasje me dt. 20.11.2023 dhe përfaqësuesi juaj e ka nënshkruar letrën e qasjes, njëkohësisht u kemi sqaruar se edhe ne ofertën tuaj ju keni dhënë deklarate për Konfidencialitet, me piket e listuara me poshtë, ndërsa po i kontestoni te operatori tjetër.

## Aneksi 3 KËRKESË PËR KONFIDENCIALITET

Për: MINISTRIA E SHËNDETËSISË

(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *[D&T Group SH.P.K. & Mercom Company SH.P.K.]* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

| *Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:* |
| --- |
| 3. Deklaratat tatimore vjetore 2020,2021,2022 ATK |
| 4. Aneksi 7 Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit |
| 5. Deklarata dhe specifikimet teknike |
| 6. Deklarate per afatin kohor te perfundimit te kontrates |
| 7. Catalogue - Autoambulance Peugeot |
| 8. Certifikatat ISO |
| 9. Certifikatat e pajisjeve mjekesore |
| 10. Deklarata e konformitetit CE |
| 11. Declaration of warranty and support |
| 12. Deklaratat dhe marreveshjet paraprake per bashkepunim |
| 13. Autorizimi i prodhuesit |
| 14. Lista e pjesëve rezervë dhe-ose artikujve të konsumit |
| 15. Deklarate katalogu 3D |

- Nuk pajtohemi me pretendimin nr. 4, meqense ne oferte OE i rekomanduar i ka prezantuar te gjitha deshmite e kerkuara dhe ne Formularin e tenderit ka ofertuar pikerisht me shpenzim te karborantit prej 8 Liter / 100km, siç ju e keni potencuar ne kete ankese.

Ne baze te sqarimeve te lartcekura shihet qarte se katalogjet tuaj jane te modifikuar dhe oferta juaj është e papergjegjshme.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Berat Marmullaku**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**